




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit Shkurt -2017**



## **P a r a t h ë n i e**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në shtator të vitit 2002 deri në muajin dhjetor 2014, ndërsa nga muaji janar 2015 është harmonizuar sipas konceptit ndërkombëtar dhe publikohet si Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Çmimet e konsumit kanë filluar të mblidhen në muajin maj të vitit 2002 i cili konsiderohet muaji bazë.

Nga muaj janar 2016 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) bazuar në rekomandimet e Eurostatit publikohet me vitin bazë **2015=100**. Çmimet mblidhen prej datës 10 deri 20 të muajit në 13 Komuna të Kosovës.

ASK nga shtatori 2002 në vazhdimësi ka publikuar në baza mujore IÇK-IHÇK dhe dymbëdhjetë publikime në baza vjetore ( 2004 - 2015)

Ky publikim përmban tabelën me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Kosovë në baza mujore janar 2010 – shkurt 2017, mesatarja vjetore 2010-2016 (2015=100), me ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje, paraqitja grafike, tabelën për peshat specifike, indeksin për muajin shkurt të vitit 2017, ndryshimet mujore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Shkurt 2017 / Janar 2017) dhe ndryshimet vjetore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Shkurt 2017 / Shkurt 2016) për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it, tabelën me çmime mesatare për disa artikuj më reprezentues dhe metodologjinë e kalkulimit të indekseve të harmonizuar të çmimeve të konsumit.

### **Shpjegim për shfrytëzuesit e të dhënave**

Pasi që seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK-it) në vend janë publikuar me bazë muaj Maj 2002=100 për periudhën maj 2002 - dhjetor 2015. Ndërsa nga muaji janar i vitit 2016 me rekomandimet e Eurostatit Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është kalkuluar me vitin bazë 2015=100 dhe janë të rikalkuluara me këtë bazë të gjitha seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) në vend dhe janë të publikuara me 09.06.2016 në Ueb-faqen e ASK-ës (në publikimin vjetor të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit 2002 – 2015). Nga janari i vitit 2016 dhe në vazhdimësi janë të publikuara seritë kohore nga muaj janar i vitit 2010.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën elektronike: E-mail [economic@rks-qov.net](mailto:economic@rks-qov.net)

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është publikim i rregullt mujor.

Publikimin përgatitën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit  
Ibish Asllani - Shef i Divizionit  
Raif Gashi - Zyrtar i lartë

Mars, 2017

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-ës  
Isa Krasniqi

## Simbolet dhe Shkurtesat

IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
COICOP	Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit
ABF	Anketa e buxhetit familjar
IHÇK	Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike – IÇK/IHÇK)
Ø	Mesatare

## Përmbajtja

	Faqe
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin shkurt 2017 .....	5
Tabela 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Shkurt 2017 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje .....	6
Grafiku 1: Mesatarja vjetore e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2016 (2015=100) .....	8
Grafiku 2: Ndryshimet vjetore në përqindje të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit....	8
Tabela 2: Peshat, IHÇK-it Shkurt 2017 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it.....	9
Tabela 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime më reprezentuese .....	11
Metodologjia e IHÇK.....	12

## **Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin shkurt 2017**

Indeksi i harmonizuar i tërësishëm i çmimeve të konsumit në vend është më i lartë për 0,2% në muajin shkurt 2017 krahasuar me muajin janar 2017. Shkalla e inflacionit e matur në muajin shkurt 2017 me muajin shkurt 2016 ishte 1,7%.

### **Shkurt 2017 / Janar 2017 0,2%**

Indeksi i harmonizuar i tërësishëm i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0,2% në muajin shkurt 2017 krahasuar me muajin janar 2017. Ngritje e indeksit të çmimeve të konsumit vërehet te nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithëra (1,2%), pemët (3,4%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.2 për qind në IHÇK-it.

### **Shkurt 2017 / Shkurt 2016 1,7%**

Indeksi i harmonizuar i tërësishëm i çmimeve të konsumit është më i lartë për 1,7% në muajin shkurt 2017 krahasuar me muajin shkurt 2016 në këtë periudhë vërehen disa ndryshime të çmimeve të artikujve dhe shërbimeve te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it. Ngritje e indeksit të çmimeve të konsumit vërehet te nëngrupet e COICOP-it: mishi (0,9%), qumështi, djathi dhe vezët (6,0%), sheqeri dhe ëmbëlsirat (7,3%), kafja, çaji dhe kakao (5,8%), duhani (5,1%), veshje (1,5%), rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera (3,9%)-(ngritje e çmimit të druve për ngrohje), përdorimi i pajisjeve për transportin personal (13,1%)-(ngritje e çmimit të naftës dhe benzinës) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,0 për qind në IHÇK-it.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: perimet (-4,1%), pajisjet audio-vizuele, fotografike për përpunimin e informatave (-4,1%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,3 për qind në IHÇK-it.


**Tabela 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Shkurt 2017 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje**

Viti	Muaji	Indeksi (2015 = 100)	Ndryshimi mujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2010	Janar	88.0	0.6	0.7
	Shkurt	88.2	0.2	1.1
	Mars	88.1	-0.1	0.8
	Prill	87.2	-1.0	1.6
	Maj	87.5	0.3	2.2
	Qershor	87.6	0.1	2.2
	Korrik	87.9	0.3	2.7
	Gusht	90.5	3.0	6.0
	Shtator	90.8	0.3	6.0
	Tetor	91.9	1.2	6.0
	Nëntor	92.3	0.4	6.2
	Dhjetor	93.2	1.0	6.5
	<b>Mesatarja vjetore 2010</b>		<b>89.4</b>	<b>:</b>
2011	Janar	94.5	1.4	7.4
	Shkurt	96.5	2.1	9.4
	Mars	97.6	1.1	10.8
	Prill	96.5	-1.1	10.7
	Maj	96.5	0.0	10.3
	Qershor	95.7	-0.8	9.2
	Korrik	95.2	-0.5	8.3
	Gusht	95.3	0.1	5.3
	Shtator	95.1	-0.2	4.7
	Tetor	96.2	1.2	4.7
	Nëntor	96.2	0.0	4.2
	Dhjetor	96.5	0.3	3.5
	<b>Mesatarja vjetore 2011</b>		<b>96.0</b>	<b>:</b>
2012	Janar	97.3	0.8	3.0
	Shkurt	98.2	0.9	1.8
	Mars	98.3	0.1	0.7
	Prill	97.6	-0.7	1.1
	Maj	97.6	0.0	1.1
	Qershor	97.3	-0.3	1.7
	Korrik	97.3	0.0	2.2
	Gusht	98.3	1.0	3.1
	Shtator	99.1	0.8	4.2
	Tetor	99.9	0.8	3.8
	Nëntor	99.5	-0.4	3.4
	Dhjetor	100.1	0.6	3.7
	<b>Mesatarja vjetore 2012</b>		<b>98.4</b>	<b>:</b>
2013	Janar	100.7	0.6	3.5
	Shkurt	100.8	0.1	2.6
	Mars	100.8	0.0	2.5
	Prill	100.0	-0.8	2.5
	Maj	99.7	-0.3	2.2
	Qershor	99.9	0.2	2.7
	Korrik	99.6	-0.3	2.4
	Gusht	99.5	-0.1	1.2
	Shtator	99.3	-0.2	0.2
	Tetor	100.1	0.8	0.2
	Nëntor	100.3	0.2	0.8
	Dhjetor	100.6	0.3	0.5
	<b>Mesatarja vjetore 2013</b>		<b>100.1</b>	<b>:</b>


**Tabela 2: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Shkurt 2017 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)**

Viti	Muaji	Indeksi (2015 = 100)	Ndryshimi mujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2014	Janar	100.9	0.3	0.2
	Shkurt	100.9	0.0	0.1
	Mars	101.1	0.2	0.3
	Prill	100.3	-0.8	0.3
	Maj	100.2	-0.1	0.5
	Qershor	100.3	0.1	0.4
	Korrik	100.4	0.1	0.8
	Gusht	100.4	0.0	0.9
	Shtator	100.6	0.2	1.3
	Tetor	100.7	0.1	0.6
	Nëntor	100.4	-0.3	0.1
	Dhjetor	100.2	-0.2	-0.4
		<b>Mesatarja vjetore 2014</b>	<b>100.5</b>	<b>:</b>
2015	Janar	100.3	0.1	-0.6
	Shkurt	100.6	0.3	-0.3
	Mars	100.7	0.1	-0.4
	Prill	99.9	-0.8	-0.4
	Maj	99.7	-0.1	-0.5
	Qershor	99.9	0.1	-0.4
	Korrik	99.6	-0.2	-0.8
	Gusht	99.7	0.1	-0.7
	Shtator	99.4	-0.3	-1.2
	Tetor	100.0	0.6	-0.7
	Nëntor	100.1	0.1	-0.3
	Dhjetor	100.0	0.0	-0.2
		<b>Mesatarja vjetore 2015</b>	<b>100.0</b>	<b>:</b>
2016	Janar	100.5	0.5	0.2
	Shkurt	100.7	0.2	0.0
	Mars	100.8	0.1	0.1
	Prill	99.8	-1.0	-0.1
	Maj	99.6	-0.2	-0.1
	Qershor	99.6	-0.1	-0.3
	Korrik	99.6	0.0	0.0
	Gusht	99.8	0.2	0.0
	Shtator	99.9	0.2	0.6
	Tetor	100.9	0.9	0.9
	Nëntor	101.0	0.1	0.9
	Dhjetor	101.3	0.4	1.3
		<b>Mesatarja vjetore 2016</b>	<b>100.3</b>	<b>:</b>
2017	Janar	102.2	0.8	1.7
	Shkurt	102.3	0.2	1.7

**Grafiku 1: Mesatarja vjetore e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2016 (2015=100)**



**Grafiku 2: Ndryshimet vjetore në përqindje të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit**





**Tabela 2: Peshat, IHÇK-it Shkurt 2017 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it**

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat %	II - 2017 2015=100	II - 2017 I- 2017	II - 2017 II - 2016
<b>00</b>	<b>Gjithsej IHÇK</b>	<b>1000.0</b>	<b>102.3</b>	<b>0.2</b>	<b>1.7</b>
<b>01</b>	<b>Ushqimi dhe pijet joalkoolike</b>	<b>376.2</b>	<b>101.9</b>	<b>0.5</b>	<b>1.0</b>
<b>01.1</b>	<b>Ushqimi</b>	<b>320.8</b>	<b>101.8</b>	<b>0.5</b>	<b>0.9</b>
01.1.1	Buka dhe drithërat	81.7	97.7	1.2	-0.5
01.1.2	Mishi	104.8	102.2	0.2	0.9
01.1.3	Peshqit	3.0	101.4	1.1	0.5
01.1.4	Qumështi, djathi dhe vezët	53.2	105.7	-0.7	6.0
01.1.5	Vajërat dhe yndyrat	7.6	102.9	-0.3	-1.8
01.1.6	Pemët	16.2	91.5	3.4	0.6
01.1.7	Perimet	31.3	105.9	1.2	-4.1
01.1.8	Sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat	14.6	114.4	0.0	7.3
01.1.9	Prodhimet ushqimore	8.4	101.8	0.3	1.1
<b>01.2</b>	<b>Pijet joalkoolike</b>	<b>55.4</b>	<b>103.6</b>	<b>0.4</b>	<b>2.1</b>
01.2.1	Kafja, çaji dhe kakao	13.0	107.7	1.0	5.8
01.2.2	Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet	42.4	102.4	0.2	1.0
<b>02</b>	<b>Pijet alkoolike, duhani</b>	<b>53.5</b>	<b>111.0</b>	<b>0.2</b>	<b>3.0</b>
02.1	Pijet alkoolike	24.6	107.3	-0.2	0.0
02.2	Duhani	28.9	114.0	0.5	5.1
<b>03</b>	<b>Veshje dhe këpucë</b>	<b>44.2</b>	<b>104.2</b>	<b>-0.2</b>	<b>2.0</b>
03.1	Veshje	34.0	103.8	-0.4	1.5
03.2	Këpucë	10.2	105.3	0.7	3.8
<b>04</b>	<b>Strehimi , uji, rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera</b>	<b>75.9</b>	<b>106.1</b>	<b>-0.1</b>	<b>2.4</b>
04.1	Pagesa aktuale për banim	6.0	97.8	0.0	-2.2
04.3	Mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit	11.3	100.6	0.3	0.0
04.4	Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin	13.4	95.5	0.0	0.0
04.5	Rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	45.2	110.0	-0.2	3.9
<b>05</b>	<b>Orenditë, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë</b>	<b>88.6</b>	<b>101.5</b>	<b>-0.4</b>	<b>0.3</b>
05.1	Orenditë dhe aparaturat, qilimat dhe shtrojat tjera për dysheme	20.7	101.9	-0.4	0.5
05.2	Tekstilet për amvisëri	3.2	101.7	-0.6	-0.1
05.3	Pajisjet shtëpiake	15.2	101.1	-0.3	-0.2
05.4	Qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës	13.6	104.3	-0.6	2.9
05.5	Veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht	15.1	101.7	-0.1	0.5
05.6	Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake	20.8	99.9	-0.3	-0.9

**Tabela 2: Peshat, IHÇK-it Shkurt 2017 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it (vazhdim)**

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat ‰	II - 2017 2015=100	II - 2017 I- 2017	II - 2017 II - 2016
<b>06</b>	<b>Shëndetësia</b>	<b>31.3</b>	<b>102.6</b>	<b>0.1</b>	<b>0.1</b>
06.1	Prodhimet dhe pajisjet mjekësore	19.3	102.9	0.1	0.1
06.2	Shërbimet ambulatore	11.0	102.4	0.0	0.0
06.3	Shërbimet spitalore	1.0	100.0	0.0	0.0
<b>07</b>	<b>Transporti</b>	<b>143.9</b>	<b>100.7</b>	<b>-0.2</b>	<b>6.8</b>
07.1	Blerja e automjeteve	46.6	99.9	0.0	-1.0
07.2	Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	74.4	101.6	0.4	13.1
07.3	Shërbimet për transport	22.9	101.0	-2.2	0.9
<b>08</b>	<b>Mjetet e komunikimit</b>	<b>39.7</b>	<b>99.3</b>	<b>-0.1</b>	<b>-0.8</b>
08.1	Shërbimet postare	2.6	104.6	0.0	4.6
08.2	Pajisjet telefonike dhe të telefaksit	6.5	95.6	-0.8	-4.9
08.3	Shërbimet telefonike dhe të telefaksit	30.6	99.6	0.0	-0.3
<b>09</b>	<b>Rekracioni dhe kultura</b>	<b>49.9</b>	<b>99.0</b>	<b>-0.1</b>	<b>-1.4</b>
09.1	Pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave	13.0	95.7	-0.3	-4.1
09.2	Pajisjet tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë	3.2	100.2	0.6	-0.6
09.3	Gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret	9.1	101.6	-0.2	-0.2
09.4	Shërbimet rekreative dhe kulturore	6.1	100.6	0.0	0.0
09.5	Gazetat, librat dhe materialet për zyra	14.4	98.7	0.0	-0.8
09.6	Pushime të organizuara	4.1	99.0	-0.5	-1.2
<b>10</b>	<b>Arsimi</b>	<b>12.4</b>	<b>99.9</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>11</b>	<b>Restorantet dhe hotelet</b>	<b>31.9</b>	<b>101.2</b>	<b>0.7</b>	<b>0.7</b>
11.1	Shërbimet hoteliere	26.8	101.7	0.4	0.8
11.2	Shërbimet për strehim	5.1	99.5	2.2	0.5
<b>12</b>	<b>Mallrat dhe shërbimet e ndryshme</b>	<b>52.5</b>	<b>101.4</b>	<b>0.3</b>	<b>0.5</b>
12.1	Kujdesi personal	16.1	101.7	-0.1	0.5
12.3	Gjërat personale	11.7	99.2	0.2	1.1
12.4	Mbrojtja sociale	1.0	105.2	0.9	0.9
12.5	Sigurimet	10.5	102.5	0.2	0.0
12.6	Shërbimet financiare	9.6	101.0	1.0	1.0
12.7	Shërbimet tjera	3.6	101.1	0.0	-0.2

**Tabela 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime më reprezentuese**

Kodi	Artikujt	Njësia matëse	II 2016	I 2017	II 2017
101	Oriz	1 kg	1.32	1.36	1.35
102	Miell gruri	1 kg	0.41	0.40	0.39
103	Bukë e bardhë	500 gr	0.29	0.27	0.28
111	Mish gjedhi pa eshtra	1 kg	6.39	6.46	6.47
112	Mish viçi	1 kg	7.06	7.34	7.41
114	Mish pule	1 kg	2.59	2.59	2.60
131	Qumësht (Tetrapak)	1 lit	0.88	0.85	0.85
133	Jogurt	1 lit	0.88	0.88	0.88
137	Vezë	30 copë	2.26	3.10	3.04
141	Vaj ushqimor luledielli	1 lit	1.20	1.11	1.10
153	Banane	1 kg	1.19	1.01	1.03
161	Patate	1 kg	0.40	0.36	0.38
162	Domate	1 kg	1.16	1.20	1.19
163	Fasule	1 kg	2.13	2.19	2.22
167	Speca të pa djegës	1 kg	1.93	1.82	1.90
175	Sheqer	1 kg	0.77	0.90	0.90
192	Kafe e bluar	1 kg	7.03	7.52	7.58
193	Çaj	1 kg	5.77	6.69	7.12
195	Uji mineral	1.5 lit	0.31	0.31	0.32
204	Birrë	0.5 lit	0.64	0.64	0.65
215	Cigare - Ronhill	1 pako	1.50	1.56	1.57
217	Cigare - Marlboro	1 pako	2.40	2.50	2.50
416	Rryma elektrike	1 kwh	0.071	0.071	0.071
418	Dru zjarri	1 m <sup>3</sup>	37.34	41.24	39.90
701	Benzin	1 lit	0.91	1.06	1.07
702	Dizel	1 lit	0.84	1.02	1.02

## Metodologjia e IHÇK

IHÇK të Kosovës, i prodhuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është i përpiluar sipas metodave të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Eurostat i ka definuar IHÇK si standard Evropian për indeksin e çmimeve të konsumit. Indeksi i kalkuluar dhe rezultatet e tyre prezantohen përmes *Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit* (COICOP), klasifikim ky ndërkombëtarë i cili klasifikon konsumin në Divizione, Grupe dhe Klasa artikujsh. Sipas COICOP-it, ASK ka ndarë 83 klasa konsumi të definuar (në nivel 5-shifror) më tutje në 408 produkte (agregat elementarë). ASK ka përcaktuar peshë për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë.

Çdo muaj IHÇK kalkullohet në dy hapa:

1. Indekset elementarë (treguesit për agregat elementarë) llogariten nga çmimet e grumbulluara duke përdorur formulën e mesatares gjeometrike të papeshuar ( të *Jevon-it*).
2. Indekset e nivelit më të lartë, dukë përfshirë vetë IHÇK, llogariten dukë nxjerrë mesataren e indekseve elementarë përmes formulës së mesatares aritmetike të peshuar (*tipi i Laspeyres*).

Peshat elementare të agreguara janë bazuar në vlerësimet e shpenzimeve të konsumit vjetor. ASK për 83 klasa konsumi bën vlerësimin e shpenzimeve të konsumit vjetor nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare (LLK); peshat brenda klasave të konsumit vijnë nga burimet e brendshme të ASK-së. Peshat specifike nga janari 2013, ishin të bazuara në vlerësimet e të dhënave të Anketës së Buxhetit Familjar (ABF) dhe Llogarive Kombëtare (LLK) që i referohen vitit 2012, ndërsa nga janari i vitit 2015 peshat specifike të rifreskuara bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2013. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike për artikuj dhe shërbime të harmonizuara sipas E-coicop (rekomandime nga Eurostatit) bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2014. Ndërsa nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen vetëm në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2015. Rifreskimi i peshave çdo vit, siguron se IHÇK reflekton trendet aktuale të konsumit.

Të gjitha blerjet monetare të bëra në vend (Brenda vendit) nga sektori i ekonomive familjare definojnë si gjithsej shpenzimet e konsumit vjetor. Ky definicion përputhet me kategorinë e LLK të quajtur *Konsumi Final Monetar i Ekonomive Familjare (HFMC)* dhe nënkupton se peshat duhet të përfshijnë vlerën e konsumit të produkteve vetanake dhe koston e banimit nga vetë pronari.

Deri në dhjetorin e vitit 2014 peshat kanë përfshi shpenzimet vetëm për konsumatorët rezident , ndërsa nga janari i vitit 2015 përfshihen edhe shpenzimet për konsumatorët jo rezident.

Për të vlerësuar ndryshimet mujore të çmimeve, stafi i ASK mbledh çmime për një numër të artikujve specifik (shpesh të quajtur *shporta e tregut*) të zgjedhura si përfaqësim i agregateve elementar. Qëllimi është që të mblidhen të gjitha çmimet, pikërisht artikujve të njëjtë për çdo muaj; kurdo që një çmim nuk ka mundësi të mblidhet, atëherë procedurat e llogaritjes duhet të aplikohen me kujdes për t'iu shmangur rezultatit të anueshëm.

Grumbulluesit e të dhënave pranë ASK-së, me seli në shtatë qendra rajonalke ( zyre rajonale statistikore), mbledhin përafërsisht 6200 çmime gjatë periudhës nga data 10-20 të çdo muaji referues. Çmimet mblidhen në supermarketet, ndërmarrje shërbyese, dyqane, tregje dhe pika tjera të shitjes me pakicë në trembëdhjetë komuna të Kosovës:

- Gjakovë
- Gjilan
- Istog
- Mitrovicë
- Pejë
- Kamenicë
- Rahovec

- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Suharekë
- Ferizaj
- Vushtri

Stafi i zyrës qendrore të ASK-së në Prishtinë mbledh çmimet për artikujdhe shërbime si rryma, uji, shërbimet postare dhe telekomunikacioni, për transportin ajror dhe hekurudhor .

### **Indekset Elementar**

Indeksi elementar për një muaj është i barabartë me indeksin e tij në muajin paraprak të shumëzuar me ndryshimin e çmimit të matur për një muaj, i llogaritur nga çmimet e grumbulluara. ASK përdor formulën e mesatares gjeometrike (apo të *Jevon-it*) për të llogaritur ndryshimet një mujore: shkalla e mesatares gjeometrike të muajit aktual në mesataren gjeometrike të çmimeve të mbledhura për muajin e kaluar.

#### Indeksi i agregatit elementar $e$ për muajin $m$

$$I_e^m = I_e^{m-1} \times \left[ \left( \prod_{i=1}^{n_e} p_i^m \right)^{1/n_e} / \left( \prod_{i=1}^{n_e} p_i^{m-1} \right)^{1/n_e} \right] \quad I_e^0 \equiv 100$$

$I_e^m$  = Indeksi i çmimit për agregatin elementar  $e$  për muajin  $m$

$I_e^{m-1}$  = Indeksi i çmimit për agregatin elementar  $e$  për muajin  $m-1$

$p_i^m$  =Çmimi për artikullin  $i$  në muajin  $m$

$p_i^{m-1}$  = Çmimi për artikullin  $i$  në muajin  $m-1$

$n_e$  = Numri i çmimeve të mbledhura për agregatin elementar  $e$

### **Indekset e Nivelit më të Lartë**

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdor formula e *Young*-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së *Lowe-it* për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhurnuara me ndryshimet e çmimeve. (Formula e *Lowe-it* është e përafërt me formulat aktuale të *Laspeyres*).

Të dy formulat, si formula e *Young*-ut dhe ajo e *Lowe-it* janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të *Laspeyres*. Aktualisht IHÇK përdor formulën e *Lowe-it* për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë periudhës së peshuar viti 2010. Peshat e reja nga të dhënat e LLK dhe ABF- vitit 2012 janë aplikuar nga janari i vitit 2014. IÇK ka kaluar në kalkulimin e indekseve me formulën *Lowe-it*; (peshat kanë qenë pjesë e shpenzimeve të vitit 2012 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve në dhjetor të vitit 2013, nga janari i vitit 2015 janë aplikuar peshat specike nga të dhënat e LLK dhe ABF të vitit 2013 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve në dhjetor të vitit 2014, ndërsa nga janari i vitit 2016 peshat specifike bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2014 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve në dhjetor të vitit 2015, Nga janari i vitit 2017 peshat

specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2015 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve në dhjetor të vitit 2016.

### **Peshat e Indeksit**

#### **Formula e Young** Peshon Agregatet Elementare brenda Grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b}{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g} = 1$$

$w_{e,g}^b$  = Pesha për agregat elementarë **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese

**b**

$x_e^b$  = shpenzimet për agregatin elementar **e** në periudhën peshuese **b**

(Aktualisht **b** = 2012)

$k_g$  = Numri i agregateve elementare në grupin **g**

#### **Formula e Young** peshon grupet brenda IHCK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{g=1}^h w_{e,g} = 1$$

$w_g^b$  = Pesha për grupin **g** në periudhën peshuese **b**

**h** = Numri i grupeve në ICK

#### **Formula e Lowe-it** peshon agregatet elementarë brenda grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v}}{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g} = 1$$

$w_{e,g}^b$  = Pesha për agregat elementar **e** brenda grupit **g** në periudhën peshuese

**b**

(Në përdorim nga Janari 2014, **b** = 2012)

$a_e^{b \rightarrow v}$  = faktor rregullues i peshave për agregatet elementar **e**

$$a_e^{b \rightarrow v} = I_e^v / \frac{1}{12} \left( \sum_{m=Jan}^{Dec} I_e^{m/b} \right)$$

$I_e^v$  = Indeksi i çmimit për agregate elementar **e** për muajin **v**

(Në përdorim nga Janari 2014, **v** = Dhjetor

2013)

$I_e^{m/b}$  = Indeksi i çmimeve për agregat elementarë **e** në muajin **m** në vitin **b**

**Formula e Lowe** peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{g=1}^h w_{e,g} = 1$$

**Indekset për Grupet e niveleve më të larta**

$$I_g^m = \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b * I_e^m \quad I_e^0 = 100$$

Për shumicën e artikujve periudha 0 është Maj 2002 ,  
por kjo periudhë ndryshon për sipas inkuadrimit të artikujve të përfshirë  
më vonë

**IHÇK i tërësishëm**

IHÇK i tërësishëm është një mesatare aritmetike e peshuar e indekseve të grupeve. Në IHÇK është përdor formula e *Young-it*, por që nga Janari i vitit 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së *Lowe-it*.

Për shkak se nëngrupet kanë baza të ndryshme indeksesh (shumica kanë për bazë Maj 2002=100, por grupet e shtuara më vonë kanë bazë tjetër, nga janari i vitit 2016 idenkset janë të kaktulara me vitin bazë 2015=100), indekset e grupeve duhet të ribazohen në një periudhë të përbashkët, që është muaji **v** (muaji paraprak para së të vihen në përdorim peshat e reja).

$$HICP^m = HICP^v \times \sum_{\varepsilon=1}^h w_{\varepsilon}^b \times \frac{I_{\varepsilon}^m}{I_{\varepsilon}^v} \quad HICP^0 = 100$$

$HICP^m$  = Indeksi i harmonizuar i çmimit të konsumit për muajin **m**

**v** = muaji paraprak para së të përdoren peshat e reja (Aktualisht **v** = 2015=100)

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politikë, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-qov.net](mailto:infoask@rks-qov.net)
- Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>